



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 125

30 korrik

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe	
Vendim i KM nr. 577, datë 2.5.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 803, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”, të ndryshuar.....	5329
Vendim i KM nr. 578, datë 17.7.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar.....	5332
Vendim i KM nr. 579, datë 17.7.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 718, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të personelit të hetimit, të inspektimit dhe të shërbimeve mbështetëse në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar.....	5334
Vendim i KM nr. 580, datë 17.7.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 1061, datë 8.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të Policisë së Burgjeve”.....	5336
Vendim i KM nr. 581, datë 17.7.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.....	5337
Vendim i KM nr. 582, datë 17.7.2013	Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar individuale për llogaritjen fillestare të pensioneve.....	5339

Vendim i KM nr. 584, datë 17.7.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	5340
Vendim i KM nr. 585, datë 17.7.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 432, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”, të ndryshuar.....	5342
Vendim i KM nr. 586, datë 17.7.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar.....	5343
Vendim i KM nr. 587, datë 10.7.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Shengjun” dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	5347
Urdhër i MD nr. 284, datë 28.6.2013	Për krijimin e regjistrit për depozitimin e të dhënave për agjencitë ndërmjetësuese të huaja, të licencuara për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e birësimit.....	5347
Vendim i GJK nr. 37, datë 25.7.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 159, datë 27.2.2013 të Këshillit të Ministrave.....	5350

VENDIM
Nr. 577, datë 2.5.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 803, DATË 21.11.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE PËR GRADAT
NË POLICINË E SHETIT DHE EKVIVALENTIMIN E TYRE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 39 e 126 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 “Tabela e ekuivalentimit dhe e funksioneve korresponduese për çdo gradë”, bashkëlidhur vendimit nr. 803, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2013 për Policinë e Shtetit.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



TABELA E EKVIVALENTIMIT DHE E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE PËR ÇDO GRADË

GRADA EKUIVALENTE	GRADA	FUNKSIONET
Drejtues i parë	Drejtor i përgjithshëm	Drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit
Drejtues	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Policisë
Kryekomisar Komisar	Drejtues i parë	Drejtor në DPPSH, drejtor në departamentet e DPPSH-së, drejtor në Drejtorinë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, drejtor i FPO-së, drejtor i Policisë Rrugore, drejtor i DPQ-së, drejtor i QFP-së, shef i asistent/sekretariatit të drejtorit të përgjithshëm, drejtor i QPMDH-së, drejtor i BKN-së, drejtor i standardeve profesionale, asistent i drejtorit të përgjithshëm, drejtor dhe shef sektori në DSSB dhe specialist koordinator në Drejtorinë e Analizës dhe Studimeve Strategjike
Nënkomisar	Drejtues	Shef sektori në DPPSH, shef sektori në departamentet e DPPSH-së, shef sektori në Drejtorinë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, shef sektori në FPO, shef sektori në Drejtorinë e Policisë Rrugore, shef sektori në QFP, shef sektori në QPMDH, shef komisarati special RENE A, shef sektori në BKN, shef sektori në Drejtorinë e Standardeve Profesionale dhe DTI, zëvendësdrejtor në DPQ, drejtor i DRK&M, specialist në seksionin e menaxhimit të nivelit të mesëm e të lartë drejtues në QFP, si dhe specialist, asistent (sekretariati) pranë zv/drejt. kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, specialist, oficer kontakti, ndërlihdës në drejtorinë BKN, specialist koordinator në sektorin e botimeve në DSSB
Kryeinspektor	Kryekomisar	Specialist në DPPSH, specialist në departamentet e DPPSH-së, specialist në Drejtorinë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, shef qendre në FPO, specialist në FPO, specialist në Drejtorinë e Policisë Rrugore, specialist në QPMDH, specialist në BKN, specialist në Drejtorinë e Standardeve Profesionale, komandant i RSBC-së, shef sektori në DPQ, shef sektori në DRK&M, shef komisarati policie, shef komisarati K&M, shef seksioni në QFP, shef komisarati special RESI dhe i ndërhyrjes së shpejtë, shef komisarati i helikopterëve, shef i IPQP-së, specialist në seksionin e menaxhimit të nivelit të parë drejtues në QFP, shef i strukturës autonome pranë DPPSH-së, shef i njësisë antiexplozivëve, shef i njësisë së negociatorëve, shef qendre FPO, shef sektori në komisaratin special RENE A
Inspektor	Komisar	Shef seksioni në DPQ, shef seksioni në DRK&M, shef seksioni në DPQ, shef seksioni në DRK&M, shef seksioni në komisarate policie, shef seksioni në komisaritet K&M, shef stacioni i K&M, shef seksioni në strukturat autonome në varësi të DPPSH-së, shef i planifikimit/koordinimit operacional në repartet speciale dhe të ndërhyrjes së shpejtë, shef i fluturimeve, komandant ekuipazhi, pilot, inxhinier e teknik

		AS-350, teknik bordi fluturues mi-8, teknik mi-8, specialist në QFP, shef seksioni në IPQP, shef seksioni në strukturat autonome DPPSH, zv/shef njësie FPO
Nëninspektor	Nënkomisar	Specialist në DPQ, specialist në DRK&M, shef stacioni policie, specialist në komisariate e stacione policie, specialist në komisariate e stacione policie të K&M, specialist në strukturat autonome në varësi të DPPSH-së, komandant grupi në repartet speciale dhe të ndërhyrjes së shpejtë, komandant grupi në RSBC, specialist në IPQP, specialist në strukturat autonome pranë DPPSH-së, përgjegjës turni në stacionet e policisë K&M
Kryeasistent Asistent i parë Asistent	Kryeinspektor	Ndihmësspecialist në strukturat e hetimit të krimeve, të Policisë Shkencore, të Policisë së Rendit, të sallave operative të drejtimit dhe koordinimit, ndihmësspecialist (kontrollor) në Policinë K&M, në forcat speciale, përgjegjës grupi, komandant skuadre
Agjent i parë Agjent	Inspektor	Funksione të nivelit zbatues në strukturat administrative mbështetëse, trupë shërbimi në të gjitha strukturat e policisë (përfshirë trupat në repartet speciale), në patrullat e përgjithshme të policisë, trupë shërbimi në forcat e ndërhyrjes së shpejtë
	Nënispektor	Punonjës policie në periudhën 2-vjeçare të provës

Shpjeguese:

Shkurtimet e përdorura në tabelën e mësipërme kanë kuptimet si më poshtë:

DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
FPO	Forcë e Posaçme Operacionale
QPMDH	Qendra e Përpunimit dhe e Mbrojtjes së të Dhënave
BKN	Bashkëpunimi dhe Koordinimi Ndërkombëtar
QFP	Qendra e Formimit Policor
DPQ	Drejtoria e Policisë në Qark
DRK&M	Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe e Migracionit
RSBC	Reparti i Sigurisë së Brendshme dhe Ceremoniali
IPQP	Instituti i Përgatitjes së Qenve të Policisë
QFMT	Qendra e Furnizimit Materialo-Teknike (strukturë autonome pranë DPPSH-së)
QSHAMT	Qendra e Shfrytëzimit dhe e Administrimit të Mjeteve të Transportit (strukturë autonome pranë DPPSH-së)
QPM	Qendra e Profilaksisë dhe e Mjekimit (strukturë autonome pranë DPPSH-së)
QSHTI	Qendra e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit (strukturë autonome pranë DPPSH-së)
DSSB	Drejtoria e Studimeve Strategjike dhe e Botimeve



VENDIM
Nr. 578, datë 17.7.2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1135, DATË 5.8.2008
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË
SHTETIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrisë të Brendshme dhe të Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 5/4, pas fjalëve “... dhe mjekë e ndihmësmjekë në strukturat e Policisë së Shtetit ...” shtohen fjalët “ ... dhe punonjësit që administrojnë lëndë narkotike në magazinën qendrore të Policisë së Shtetit, si dhe punonjësit e prodhimit të vulave.”.

c) Në fund të pikës 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Zbatimi i kësaj shtese për punonjësit aktualë, i miratuar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të vazhdojë deri në fund të vitit 2013.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për politikën e rritjes së pagave për vitin 2013.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 korrik 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHETIT

Niveli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi										
			Në funksione organike për hetimin e krimeve kundër krimit të organizuar. Oficerët e Policisë Gjyqësore. Specialistë të policisë në zonë. Në funksione organike të mbrojtjes së të miturve dhe dhunës në familje. Në funksione të Drejtorisë së Bashkëpunimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar	Në funksione të Forcës së Posaçme dhe Oficerë të Policisë Gjyqësore pranë Prokurori së për Krimet e Rënda	Në funksione të sigurisë publike. Policia Rrugore. Qendra e Emergjencave e Sallave Operative. Ruajtja e siguria e objekteve	Në funksione ndalim paraburgimi	Në funksione organike të Policisë Kufitare dhe Migracionit	Në funksione operuese të Forcave Speciale (Shef kom., shef plan. koord. op. në RENEA. Helikopterët Njësia Antieksplziv. Njësia e Negociatorëve dhe Njësia e Lëvizshme Territoriale për Kufirin e Migracionin, (Shef dhe z/shef njësie)	Në funksione operuese Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë (shef komisarati, shef planifikimi dhe koordinimi operacional)	Drejtor e zv/drejtor i Policisë së Qarkut. Shef komisarati. Shef stacioni. Komandant i Rep. të Sigurisë së Brendshme e Ceremonialit	Në funksione të Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë Komisarati special RESI (shef kom., shef plan. koord.) dhe njësia operacionale e mbrojtjes së dëshmitarëve)	Në funksione të shërb. mbështetëse dhe administrativë në Policinë e Shtetit	Në funksione organike drejtor dhe zëvendës drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Drejtor i Policisë së qarkut Tiranë dhe Drejtorja e Forcave të Lëvizshme Operacionale
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
Niveli zbatues	Nëninspektor	39000	6500		5500	6500	5500	40000	7000		30000	2000	
	Inspektor	42500	6500	16500	5500	6500	5500	40000	7000		30000	2000	
	Kryeinspektor	47500	6500	17500	5500	6500	5500	40000	7000		30000	2000	
Niveli i parë drejtues	Nënkomisar	57000	6500	18500	5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	
	Komisar	63500	6500	19500	5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	
	Kryekomisar	84000	6500	22000	5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	15000
Niveli i mesëm drejtues	Drejtuës	95500	6500	20000	5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	15000
	Drejtuës I	99000	6500		5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	15000
Niveli i lartë drejtues	Zv/drejtor i përgjithshëm	110000											15000
	Drejtor i përgjithshëm	119500											20000



VENDIM
Nr. 579, datë 17.7.2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 23.6.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË PERSONELIT TË HETIMIT, TË
INSPEKTIMIT DHE TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE NË SHËRBIMIN E KONTROLLIT TË
BRENDSHËM NË MINISTRINË E BRENDSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 51 të ligjit nr. 10 002, datë 6.10.2008 “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Brendshme”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 718, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit hetues të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr. 2 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit civilë inspektues dhe mbështetës të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 6, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për politikën e pagave për vitin 2013.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT HETUES
TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM**

Nr.	Grada	Funksionet organike	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
1	2	3	4	5
1	Asistent	Ndihmëspecialist në provë në trupën operacionale	39000	6500
2	Agjent	Ndihmëspecialist në trupën operacionale	42000	8000
3	Agjent I	Drejtues grupi/ndihmëspecialist në trupën operacionale	47000	8000
4	Hetues	Specialist hetimi në nivel vendor. Specialist hetimi në nivel vendor në provë	57500	8000
5	Hetues I	Specialist hetimi në nivel vendor	70000	8000
	Hetues I	Specialist hetimi në nivel qendror Shef seksioni në nivel qendror Shef sektori në nivel vendor	78500	10000

6	Drejtues	Shef seksioni në nivel qendror Shef sektori në nivel vendor Shef sektori në nivel qendror	85500	10000
7	Drejtues I	Shef sektori në nivel qendror Drejtor drejtorie në nivel vendor Drejtor drejtorie në nivel qendror	96500	10000
8	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm (drejtor i departamentit të hetimit)	99000	15000
9	Drejtor i përgjithshëm	Drejtor i përgjithshëm	107800	20000

Lidhja nr. 2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT CIVILË INSPEKTUES DHE MBËSHTETËS TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Nr.	Klasifikimi i niveleve	Funksionet organike	Kategoria e pagës	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa e pozicionit	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	1	2	3	4	5	6	7
1.	Punonjës të nivelit të lartë drejtues	Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit	II-b	1	2%	91700	
2.	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	Drejtor në nivel qendror (për shërbimet mbështetëse)	III-a	1	2%	74400	
3.	Punonjës të nivelit bazë drejtues	Shef sektori në nivel qendror (në Drejtorinë e Inspektimit)	III-a	1	2%	74400	5000
4.	Punonjës të nivelit bazë zbatues	Inspektor në nivel qendror (në Drejtorinë e Inspektimit)	III-b	1 ose 2	2%	57000	5000
		Specialist në nivel qendror	III-b	1 ose 2	2%	57000	
		Specialist trajnimi në nivel qendror për punonjësit e SHKB-së	IV-a	1 ose 2	2%	45800	5000
		Specialist në nivel qendror	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	45800	
		Specialist në nivel qendror	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	35500	



VENDIM
Nr. 580, datë 17.7.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1061, DATË 8.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 10 032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrisë të Brendshëm dhe të Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1061, datë 8.7.2010 të Këshillit të Ministrave, lidhja nr. 1 që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për politikën e rritjes së pagave për vitin 2013.
 3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi		
			Në funksion të Policisë të Regjimeve të Jashtme, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe grupet e ruajtjes së objekteve në D.P.Burgjeve	Në funksion të Policisë të Regjimeve të Brendshme, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe grupet e transferim- shoqërimit në IEVP dhe në D.P.Burgjeve	Në funksion të policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
1	2	3	4	5	6
Bazë	Nëninspektor	37500	4000	8000	
	Inspektor	41000	4000	8000	
	Kryeinspektor	46000	4000	8000	2000
				8000	
I Mesëm	Nënkomisar	56000	4000	8000	2000
	Komisar	60500	4000	8000	2000
	Kryekomisar	83000	4000	8000	2000
I lartë	Drejtues	95000			6500
	Drejtues I	99000			10000

VENDIM
Nr. 581, datë 17.7.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1114, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR. 7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, NR. 9136, DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, DHE NR. 7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 2 të kreut II, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë jo më pak se 19 026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekë, ndërsa paga maksimale mujore të jetë 95 130 (nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tridhjetë) lekë.

2. Pikat 1, 2, 6, 7, 9, 10, 11 e 13 të kreut III, ndryshohen si më poshtë vijon:

“1. Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 5 308 (pesë mijë e treqind e tetë) lekë.

Kontributi minimal mujor sipas degëve të sigurimit të jetë:

	në %	në lekë
Dega e sigurimit të sëmundjeve	0.3	57
Dega e sigurimit të barrë-lindjeve	1.4	266
Dega e sigurimit të pensioneve	21.6	4110
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	0.3	57
Dega e sigurimit të papunësisë	0.9	171
Sigurimet shëndetësore	3.4	647

2. Shuma minimale mujore e kontributit të sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarin dhe për pjesëtarët e familjes, të patrajtuar me pagë, të jetë 7 për qind e pagës minimale mujore, e barabartë me 1 332 (një mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë.

...

6. I vetëpunësuarit, i vetëpunësuarit në ortakëri, i vetëpunësuarit që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.8.2013 e në vazhdim, paguan për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind sigurim shoqëror dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 19 026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekësh, të barabartë me 5 708 (pesë mijë e shtatëqind e tetë) lekë në muaj.

7. I vetëpunësuarit, për pjesëtarët e familjes së tij mbi 16 vjeç, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërisht (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.8.2013 e në vazhdim, paguan kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind sigurim shoqëror dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 19 026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekësh, të barabartë me 5 708 (pesë mijë e shtatëqind e tetë) lekë në muaj.



...

9. Personat e vetëpunësuar në veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor në shumën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.

10. Personat mbi 16 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pronësia e që nuk janë të punësuar diku tjetër, duke filluar nga 1.8.2013 e në vazhdim, të paguajnë kontribut vetëm për sigurimin shëndetësor në masën 7 për qind të pagës mujore minimale, prej 19 026 (nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e gjashtë) lekësh.

11. Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve, që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 23 000 (njëzet e tre mijë) lekë.

...

13. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore për personat, që punojnë si punëtorë shtëpie, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në muaj.”.

3. Nënndarja “vi” e shkronjës “a” të pikës 1 të kreut VII, ndryshohet si më poshtë vijon:

“vi) Të dhënat mujore dhe progresive për detyrimet për kontributet e papaguara në afat për çdo subjekt, si dhe për kreditorët për kontribute të paguara më tepër se detyrimi i llogaritur sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave.”.

4. Kreu VIII ndryshohet si më poshtë vijon:

“VIII. SHUMA BAZË E PËRFITIMEVE

1. Në mbështetje të neneve 2, 32, 36 e 48 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 12 024 (dymbëdhjetë mijë e njëzet e katër) lekë në muaj.

2. Në mbështetje të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma e përfitimit për personat, që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e masës së pensionit, të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 8 233 (tetë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë në muaj.

3. Në mbështetje të pikës 3 të nenit 27 të pikës 2 të nenit 59 dhe të nenit 60 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes të të ardhurave për barrë-lindje, për rastet kur e drejta e përfitimit ka lindur, por përfituesja nuk ka pagë gjatë gjithë muajve të vitit të fundit kalendarik, llogaritet duke bashkuar shumën e pagave faktike për muajt që është derdhur kontribut për sigurimet shoqërore me shumën e pagave minimale, të përcaktuara për efekt të derdhjes së kontributit të sigurimit shoqëror për muajt pa kontribut, pjesëtuar me 12 muaj.

4. Në mbështetje të pikës 4 të nenit 27 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit për gratë, të cilat e kanë periudhën e fundit të sigurimit si të vetëpunësuar në bujqësi, nga data 1.8.2013 e në vazhdim, të jetë 8 233 (tetë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë në muaj.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.8.2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 582, datë 17.7.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSUAR
INDIVIDUALE PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë si më poshtë vijon:

Për vitin 2012	1.00
Për vitin 2011	1.03
Për vitin 2010	1.00
Për vitin 2009	1.01
Për vitin 2008	1.04
Për vitin 2007	1.11
Për vitin 2006	1.04
Për vitin 2005	1.02
Për vitin 2004	1.12
Për vitin 2003	1.10
Për vitin 2002	1.09
Për vitin 2001	1.14
Për vitin 2000	1.07
Për vitin 1999	1.09
Për vitin 1998	1.05
Për vitin 1997	1.22
Për vitin 1996	1.09
Për vitin 1995	1.37
Për vitin 1994	1.32

2. Vendimi nr. 566, datë 3.8.2011 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 584, datë 17.7.2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 839, DATË 11.12.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 20 të ligjit nr. 9410, datë 12.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi e shtesa e mëposhtme:

a) Lidhja nr. 1 “Paga bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në fund të pikës 5/1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Zbatimi i kësaj shtese për ushtarakët aktivë aktualë, i miratuar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të vazhdojë deri në fund të vitit 2013.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për politikën e rritjes së pagave, për vitin 2013.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PAGA BAZË SIPAS GRADËS DHE VITEVE TË SHËRBIMIT PËR USHTARAKËT AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA

	Vitet e shërbimit														
OFICERË	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Gj. Lejtnant (admiral)															157000
Gj. Major (nënadmiral)														147000	150000
Gj. Brigade (kundëradmiral)												117000	118000	118000	
Kolonel (kapiten i rangut I)										93000	94500	96500	98500	100000	
Nënkolonel (kapiten i rangut II)								74000	75200	76400	77700	78900	80300	81500	
Major (kapiten i rangut III)							58500	59500	60500	61500	63500	64500	65500		
Kapiten (kapiten lejtant)				52600	53100	53400	54200	54900	55600	56400	57000				
Toger (lejtant)			48600	49900	50800	52100	52600								
Nëntoger (nënlejtant)	45100	46200	47300	48000	48100	48600									
	Vitet e shërbimit														
NËNOFICERË	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
K/kapter										53500	54500	56200	57300	58300	
Kapter								45800	47300	48200	49000	50300	52300		
Rreshter						41000	42300	44500	45800	47300	48200				
Tetar			38500	39200	40100	41000	41500	42500	43500	44500					
Nëntetar	33400	34200	35500	36500	38500	40000									
	Vitet e shërbimit														
USHTARË PROFESIONISTË	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar/ detar profesionist II	33300	34600	35700	37300	38500										
Ushtar/ detar profesionist I	30500	32000													
USHTARË TË SHËRBIMIT TË DETYRUESHËM E STUDENTË USHTARAKË															
	Vitet e shërbimit														
	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar rekrut II/ detar II	3500														
Ushtar rekrut I/ detar I	3000														
Studentë ushtarakë	3000														



VENDIM
Nr. 585, datë 17.7.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 432, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, TRAJTIMIN ME PAGË DHE
SHTESA MBI PAGË PËR PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 e 22 të ligjit nr. 9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetecat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 432, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, lidhja nr. 2 “Struktura dhe nivelet e pagave, sipas klasifikimit të funksioneve, për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për politikat e rritjes së pagave për vitin 2013.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 2

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE SIPAS KLASIFIKIMIT TË FUNKSIONEVE, PËR
PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT**

Nivelet e klasifikimit	Klasifikimi i punonjësve sipas niveleve	Klasa për çdo nivel klasifikimi	Paga bazë mujore për klasë në lekë	Shtesa për vjetërsi në %	Shtesa për gradë në %
1	2	3	4	5	6
I	Punonjës mbështetës	I.1	22000	1%	2%
		I.2	24000	1%	2%
		I.3	27500	1%	3%
		I.4	30500	1%	5%
		I.5	39000	1%	6%
		I.6	40000	1%	6%
II	Punonjës të nivelit zbatues	II.1	44000	1%	8%
		II.2	47000	1%	12%
		II.3	48500	1%	12%
III	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	III.1	52000	1%	14%
		III.2	53500	1%	16%
IV	Punonjës të nivelit të lartë drejtues	IV.1	57500	1%	20%
		IV.2	64500	1%	20%
Jashtë klasifikimit	Inspektor i përgjithshëm në SHISH		126000	0%	0%

VENDIM
Nr. 586, datë 17.7.2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1619, DATË 2.7.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË
QEVERISJES VENDORE PËR EFEKT PAGE DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, dhe të neneve 24, 32 e 54 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1619, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat “a” deri në “e” të pikës 1 të vendimit, ndryshohen si më poshtë vijon:

“a) Për Bashkinë e Tiranës:

- Kryetari 140 000 - 174 760 lekë.

- Nënkyetari 130 000 - 140 000 lekë.

b) Për njësitë e qeverisjes vendore me mbi 100 000 banorë:

- Kryetari 92 000 - 140 000 lekë;

- Nënkyetari 60 000 - 94 000 lekë.

c) Për njësitë e qeverisjes vendore me 50 001 - 100 000 banorë:

- Kryetari 60 600 - 117 500 lekë.

- Nënkyetari 49 500 - 92 500 lekë.

ç) Për njësitë e qeverisjes vendore me 20 001 - 50 000 banorë:

- Kryetari 51 500 - 92 500 lekë.

- Nënkyetari 41 400 - 79 500 lekë.

d) Për njësitë e qeverisjes vendore me 5 001 - 20 000 banorë:

- Kryetari 41 400 - 79 500 lekë.

- Nënkyetari 28 300 - 70 500 lekë.

dh) Për njësitë e qeverisjes vendore me nën 5 000 banorë:

- Kryetari 37 400 - 56 100 lekë.

- Nënkyetari 27 300 - 43 900 lekë.

e) Për këshillin e qarkut:

- Kryetari 87 900 - 133 000 lekë.

- Nënkyetari 57 600 - 92 000 lekë.”.

2. Lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të Bashkisë së Tiranës”, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Lidhja nr. 2 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe për nëpunësit e komunave”, që përmendet në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Lidhja nr. 3 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të këshillit të qarkut”, që përmendet në pikën 4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Lidhja nr. 5 “Struktura dhe kufijtë e pagave për punonjësit e policisë të bashkive e të komunave”, që përmendet në pikën 13, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.



6. Në pikën 18, vlera "... 33 000 (tridhjetë e tre mijë) lekë në muaj" bëhet "...34 000 (tridhjetë e katër mijë) lekë në muaj".

7. Në pikën 19, vlera "... nga 21 000 (njëzet e një mijë) deri në 33 000 (tridhjetë e tre mijë) lekë në muaj" bëhet "... nga 22 000 (njëzet e dy mijë) deri në 34 000 (tridhjetë e katër mijë) lekë në muaj.".

II. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2013, të përballohen nga të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore për vitin 2013.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2013.

Lidhja nr. 1

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKINË E TIRANËS

Klasa	Kategoritë	PAGA MUJORE (LEKË)			
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	1	2%	0	Nga 69.000 deri 118.000
II	II-a	1	2%	0	Nga 66.000 deri 107.800
	II-b	1	2%	0	Nga 58.000 deri 91.700
III	III-a	1	2%	0	Nga 32.000 deri 74.400
	III-a/1	1	2%	0	Nga 29.000 deri 65.200
	III-b	1 ose 2	2%	0	Nga 27.000 deri 57.000
IV	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 25.000 deri 45.800
	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 23.000 deri 35.500

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKITË E TJERA, NJËSITË BASHKIAKE TË TIRANËS DHE NËPUNËSIT E KOMUNAVE

Klasa	Kategoritë	Paga individuale		PAGA MUJORE (LEKË)				
				Shtesa e pozicionit				
				<i>Njësi të qeverisjes vendore me mbi 100 000 banorë</i>	<i>Njësi të qeverisjes vendore me 50001- 100 000 banorë</i>	<i>Njësi të qeverisjes vendore me 20001- 50000 banorë</i>	<i>Njësi të qeverisjes vendore me 5001- 20000 banorë</i>	<i>Njësi të qeverisjes vendore me më pak se 5000 banorë</i>
	<i>1</i>		<i>2</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6</i>	<i>7</i>	<i>8</i>
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi në punë	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion
I	I-b	1	2%	Nga 25.000 deri 70.000	Nga 22.200 deri 63.225	Nga 20.600 deri 51.450	Nga 19.600 deri 35.900	Nga 17.000 deri 30.100
II	II-a	1	2%	Nga 24.000 deri 66.450	-	-	-	-
	II-b	1	2%	Nga 20.600 deri 56.600	Nga 19.600 deri 51.450	Nga 17.000 deri 41.310	Nga 16.500 deri 35.900	Nga 16.000 deri 27.170
III	III-a/1	1	2%	Nga 20.000 deri 50.360	Nga 18.600 deri 45.100	Nga 16.700 deri 39.130	Nga 15.500 deri 31.700	Nga 15.000 deri 26.300
	III-b	1 ose 2	2%	Nga 19.600 deri 45.900	Nga 17.000 deri 42.330	Nga 16.300 deri 37.000	Nga 15.000 deri 29.440	Nga 14.000 deri 25.760
IV	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	Nga 13.000 deri 32.800	Nga 13.000 deri 30.600	Nga 12.000 deri 29.500	Nga 12.000 deri 27.900	Nga 12.000 deri 22.100
	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	Nga 12.000 deri 30.100	Nga 11.500 deri 26.800	Nga 11.500 deri 22.500	Nga 11.000 deri 22.000	Nga 11.000 deri 21.500

Shënim. Këshilli i bashkisë dhe i komunës në përcaktimin e shtesës në pagë për pozicion, sipas ndarjes në njësi vendore, bazohet në numrin e banorëve të Regjistrit të Gjendjes Civile në fillim të vitit kalendarik.



NIVELET E PAGAVE PËR NËNPUNËSIT CIVILË NË KËSHILLIN E QARKUT

Klasa	Kategoritë	PAGA MUJORE (LEKË)			
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	1	2%	0	Nga 36.000 deri 76.850
II	II-a	-	-	0	-
	II-b	1	2%	0	Nga 23.500 deri 58.770
III	III-a/1	1	2%	0	Nga 23.500 deri 51.400
	III-b	1 ose 2	2%	0	Nga 19.000 deri 47.000
IV	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 13.000 deri 36.500
	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 12.500 deri 23.000

STRUKTURA DHE KUFIJTË E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË TË BASHKIVE E TË KOMUNAVE

Emërtesa	Paga (lekë /muaj)	
	Nga	deri
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	76400	86850
Kryeinspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore me mbi 50000 banorë	60800	69150
Kryeinspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50000 banorë	47280	52500
Inspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	60800	69150
Inspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore me mbi 50000 banorë	43120	48350
Inspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50000 banorë	36880	42100
Punonjës i Policisë Bashkiake të Tiranës	47280	52500
Punonjës i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, me mbi 50000 banorë	36880	42100
Punonjës i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50000 banorë	34800	40000
Punonjës i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, deri në 5001 banorë	31680	34800

VENDIM
Nr. 587, datë 10.7.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË
HIDROCENTRALIT “SHENGJUN” DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN
PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Shengjun” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “V&A Energji Klos” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Shengjun”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR
Nr. 284, datë 28.6.2013

**PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT PËR DEPOZITIMIN E TË DHËNAVE PËR AGJENCITË
NDËRMJETËSUESE TË HUAJA, TË LICENCUARA PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË
FUSHËN E BIRËSIMIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 399, datë 1.6.2011 “Për përbërjen dhe rregullat e funksionimit të Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja”,

URDHËROJ:

1. Krijimin e regjistrit për depozitimin e të dhënave për agjencitë ndërmjetësuese të huaja, të licencuara për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e birësimit (më poshtë “Regjistri”).

2. Personi i autorizuar përgjegjës për administrimin e Regjistrit, regjistron të dhënat për agjencitë ndërmjetësuese të huaja, të licencuara, të paraqitura nga Komisioni për Miratimin të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja, pas miratimit për dhënie e licencës.

3. Regjistri mbahet në formë elektronike (digjitale).

4. Faqet e Regjistrit ndahen në 9 kolona, sipas modelit të paraqitur në shtojcën bashkëlidhur këtij urdhri. Kolonat kanë emërtimet e mëposhtme:



- a) nr. (numri rendor i kërkesës që do të regjistrohet);
- b) data e depozitimit të kërkesës;
- c) identiteti i personit të autorizuar për të paraqitur kërkesën (emri, atësia, mbiemri, vendlindja dhe vendbanimi);
- d) numri i licencës;
- e) data e fillimit të veprimtarisë nga shteti përkatës për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e birësimeve;
- f) emri/emrat e drejtuesve të agjencisë ndërmjetësuese të huaj (emri, atësia, mbiemri, vendlindja dhe vendbanimi);
- g) emërtimi dhe lloji i shoqërisë;
- h) selia e shoqërisë;
- i) shënime (pasqyrohen të dhënat që nuk përfshihen në rubrikat e tjera dhe që çmohen se janë të rëndësishme për t'u pasqyruar).

5. Të dhënat e pasqyruara në Regjistër hartohen edhe në formatin shkresor, i cili, pasi nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit, vulloset dhe ruhet në sektorin e arkiv protokollit.

6. Personi i autorizuar përgjegjës, i caktuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, për administrimin e Regjistrit për depozitimin e të dhënave për agjencitë ndërmjetësuese të huaja, të licencuara përditëson të paktën një herë në vit Regjistrin dhe siguron publikimin e tij në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

7. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi



VENDIM
Nr. 37, datë 25.7.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Elta Milori, në datën 18.6.2013, mori në shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura çështjen me nr. 15 Akti, që i përket:

KËRKUES: Aleksandër Çela, i përfaqësuar nga avokati Koli Bele, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave, i përfaqësuar nga Ivi Kaso, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 159, datë 27.2.2013 të Këshillit të Ministrave.

BAZA LIGJORE: Neni 115, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi është zgjedhur kryetar i komunës Dardhas, Pogradec, në zgjedhjet lokale të vitit 2011.

2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, me shkresën nr. 2533, datë 8.7.2011, ka vënë në dijeni kërkuesin, para fillimit të detyrës, për detyrimin që kishte lidhur me deklarin e pasurisë (të luajtshme e të paluajtshme)¹. Formulari duhet të dorëzohej jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i detyrës, në rast të kundërt zbatohet sanksioni i dënimit me gjobë nga 20 000 lekë deri në 30 000 lekë².

3. Në kushtet kur kërkuesi nuk përmbushi detyrimin e mësipërm brenda afatit të përcaktuar në ligj, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, me vendimin nr. 81, datë 19.9.2011, mori ndaj tij masën administrative të dënimit me gjobë, në shumën prej 25 000 lekësh. Ndaj këtij vendimi kërkuesi nuk ka bërë ankim.

¹ Neni 9 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me ndryshimet e vitit 2006. Neni 5/1 aktual pas ndryshimeve me ligjin nr. 85, datë 18.9.2012.

² Neni 44, pika “c” i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

4. Meqenëse kërkuesi edhe më pas refuzonte të dorëzonte formularin e deklaramit të pasurisë, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, në datën 30.11.2011, ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pogradec, për veprën penale të “Refuzimit për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, të parashikuar nga neni 257, shkronja “a”, pika 1 e Kodit Penal.

5. Pas këtyre veprimeve, në datën 16.1.2012 kërkuesi ka dorëzuar formularin e deklaramit të pasurisë dhe në datën 17.1.2012 ka paguar vlerën e gjobës prej 25 000 lekësh në Raiffeisen Bank.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin nr. 43-2012-420, datë 19.3.2012, ka vendosur deklaramin fajtor të Aleksandër Çelës, kryetar i komunës Dardhas, Pogradec, për kryerjen e veprës penale: “Refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga neni 257, shkronja “a”, pika 1 i Kodit Penal dhe dënimin me gjobë në shumën 100 000 lekë. Në këtë proces penal është proceduar me gjykim të shkurtuar.

7. Pas marrjes së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 172/1 prot., datë 6.2.2013, i ka dërguar informacion Ministrisë së Brendshme.

8. Ministria e Brendshme, me shkresën nr. 1230 prot., datë 19.2.2013, ka dërguar pranë Këshillit të Ministrave projektvendimin “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Dardhas, z. Aleksandër Çela”, shoqëruar me relacionin përkatës.

9. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 159, datë 27.2.2013, ka vendosur shkarkimin e kryetarit të komunës Dardhas, Pogradec, me motivacionin “për shkak të kryerjes së veprës penale”.

10. Ministria e Brendshme, me shkresën nr. 1230/2 prot., datë 26.3.2013, i është drejtuar Prefektit të Qarkut Korçë, duke dërguar vendimin e shkarkimit, dhe ka kërkuar prej tij dërgimin e një kopjeje të vendimit, këshillit të komunës Dardhas, Pogradec, këshillit të qarkut, degës së thesarit dhe drejtorisë së policisë, qarku Korçë.

11. Me shkresën nr. 4 prot., datë 29.3.2013, kërkuesi i është drejtuar Ministrisë së Brendshme, duke kërkuar informacion dhe komunikim zyrtar për vendimin e shkarkimit.

12. **Kërkuesi**, në datën 1.4.2013, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimit, objekt shqyrtimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke parashtruar:

12.1 Për vendimin e shkarkimit është vënë në dijeni pas botimit në Fletoren Zyrtare, në datën 18.03.2013³, pasi nuk i është komunikuar zyrtarisht nga organi përgjegjës.

12.2 I është cenuar e drejta për t’u njohur me shkeljet e atribuara, arsyet e shkarkimit, si dhe e drejta për t’u mbrojtur para organit procedues.

13. **Subjekti i interesuar**, Këshilli i Ministrave, kërkoi rrëzimin e kërkesës, duke paraqitur prapësimet si më poshtë:

13.1 Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*. Afati 15-ditor, i përcaktuar në nenin 115, pika 2, të Kushtetutës, fillon nga dita e marrjes së vendimit të Këshillit të Ministrave.

13.2 Pretendimi i kërkuesit, se nuk ka marrë dijeni për vendimin e shkarkimit, është i pabazuar. Vendimi i shkarkimit është bazuar në një vendim gjykate, për të cilin kërkuesi ka pasur dijeni. Këshilli i Ministrave nuk ka asnjë detyrim për të komunikuar aktet. E drejta e informimit mbrohet nga neni 47 i Kodit të Procedurave Administrative.

II

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuesit (*ratione temporis*)

14. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, pretendon se kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese jashtë afatit prej 15 ditësh, pasi vendimi i Këshillit të Ministrave mban datën 27.2.2013, ndërsa kërkesa është paraqitur në datën 1.4.2013.

³ Fletore Zyrtare nr. 35, datë 18.3.2013.



15. Gjykata çmon se ndryshe nga pretendimi i subjektit të interesuar, kërkuesi e ka ushtruar ankimin brenda afatit që parashikon neni 115 i Kushtetutës.

16. Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur në gjykim, rezulton se vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 159, datë 27.2.2013 “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Dardhas, Pogradec” është botuar nga Qendra e Botimeve Zyrtare, në Fletoren Zyrtare të datës 18.3.2013.

17. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka pranuar se si datë e fillimit të afateve të ankimit ndaj aktit individual, që cenon të drejtat e personit, do të konsiderohet data e marrjes dijeni nga personi për ekzistencën e aktit, pavarësisht formave të tjera të publikimit (*shih vendimet nr. 39, datë 29.12.2005; nr. 30, datë 28.12.2006; nr. 22, datë 7.10.2008; nr. 15, datë 8.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në çështjen në shqyrtim, në rrethanat kur nuk provohet se kërkuesi mund të jetë vënë në dijeni më parë, si datë e marrjes dijeni për vendimin e shkarkimit do të llogaritet data 18.3.2013, e botimit në Fletoren Zyrtare, datë së cilës i referohet dhe kërkuesi. Duke qenë se kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 1.4.2013, rezulton se kërkuesi ka respektuar afatin 15-ditor të ankimit e, për rrjedhojë, legjitimohet *ratione temporis*.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor

19. Kërkuesi pretendon se Këshilli i Ministrave, gjatë procesit të vendimmarrjes, nuk ka respektuar kërkesat e Kodit të Procedurave Administrative për njoftimin e personit që preket nga ky procedim dhe për procedurat e marrjes së këtij vendimi.

20. Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 115, pikat 2 e 3 të Kushtetutës, është organi i vetëm që shqyrton ankesën e organit të qeverisjes vendore, kundër vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin ose shpërndarjen e tij. Ajo e bën këtë shqyrtim si nga pikëpamja e faktit, ashtu dhe nga pikëpamja e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural. Prandaj, kjo Gjykatë, në çështjen në shqyrtim, duke respektuar standardet e një procesi të drejtë ligjor, i krijoi kërkuesit mundësinë e mbrojtjes nëpërmjet paraqitjes së provave dhe argumenteve të veta për rrethanat e faktit.

21. Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ. Në këtë kuptim, ajo ka theksuar se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore (*shih vendimin nr. 76, datë 25.4.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar, gjithashtu, se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, ka qenë një proces i rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 40, datë 22.9.2011; nr. 25, datë 28.10.2005; nr. 7, datë 28.2.2000 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në të njëjtën linjë me jurisprudencën e saj, Gjykata vlerëson se edhe në rastin në shqyrtim, pretendimi i kërkuesit, për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, është i pabazuar.

24. E drejta për t’u dëgjuar, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes, garantohet dhe në procesin administrativ, përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Gjykata është shprehur se e drejta për t’u dëgjuar, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij, ose avokatit të zgjedhur prej tij. Megjithatë, sipas nenit 96/2 të Kodit të Procedurave Administrative, organi që zhvillon procedurën mund të mos i lejojë palët të shprehen kur këto kanë pasur rast t’i japin mendimet e tyre në një procedurë të mëparshme. Kështu, në një rast të ngjashëm, Gjykata është shprehur se “masa e marrë nga Këshilli i Ministrave bazohet vetëm në rezultatet e kontrolleve të bëra në Bashki, për të cilat kërkuesi ka paraqitur argumentet e veta” (*shih vendimin nr. 30, datë 28.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në çështjen në shqyrtim, vendimi nr. 159, datë 27.2.2013 i Këshillit të Ministrave, për

shkarkimin nga detyra të Aleksandër Çelës, kryetar i komunës Dardhas, Pogradec, bazohet në një vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjatë gjykimit të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, kërkuesi ka marrë pjesë në seancën gjyqësore, ku i janë dhënë mundësitë për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, duke paraqitur parashtrimet e tij rreth akuzës për të cilën ka kërkuar dhe gjykim të shkurtuar. Duke qenë se kërkuesi është njohur paraprakisht me shkakun për të cilin është vendosur shkarkimi i tij nga detyra, kryerja e një veprë penale, Gjykata vlerëson se ai e ka shprehur qëndrimin lidhur me shkeljen e konstatuar.

26. Gjykata çmon se mungesa e njoftimit të kërkuesit nga Këshilli i Ministrave, lidhur me fillimin e procedurave administrative për shkarkimin e tij dhe më pas për mënyrën e përfundimit të tyre, nuk e bën procesin e zhvilluar ndaj tij të parregullt në kuptimin substancial, përderisa, siç do të trajtohet dhe më poshtë, nuk do të kishte asnjë ndikim në vendimmarrjen për shkarkimin e tij nga detyra.

27. Megjithatë, nisur nga çështja konkrete, Gjykata e sheh me vend t'i sugjerojë Këshillit të Ministrave rishikimin e veprimtarisë së tij në rastet e fillimit të procedurave administrative për shkarkimin e organeve të zgjedhura.

28. Organi ndaj të cilit ka filluar procedimi, pavarësisht shkakut mbi të cilin bazohet vendimi i shkarkimit, nëse jemi para një shkeljeje të rëndë të ligjit dhe të Kushtetutës apo kryerjes së veprës penale bazuar në një vendim të formës së prerë, si rregull duhet të vihet në dijeni, në respekt të këtyre institucioneve dhe rëndësisë që paraqesin në organizimin dhe funksionimin e shtetit.

29. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit, sipas të cilit Këshilli i Ministrave, gjatë procesit të vendimmarrjes për shkarkimin e tij, nuk ka respektuar procedurat e njoftimit të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe, për rrjedhojë, ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duhet të rrëzohet si i pabazuar.

C. Lidhur me pretendimin për shkarkimin pa të drejtë nga detyra e kryetarit të komunës

30. Kërkuesi pretendoi gjatë gjykimit se edhe për sa i përket themelit, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 159, datë 27.2.2013, për shkarkimin e tij nga detyra, është i pabazuar. Sipas tij, dënimi nga gjykata për kryerjen e një kundërvajtjeje penale, për shkak të rëndësisë së paket të saj, nuk e justifikon marrjen e një mase ekstreme nga ana e Këshillit të Ministrave.

31. Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar. Shkelja që i atribuohet kërkuesit, mbi të cilën është mbështetur vendimi objekt shqyrtimi për shkarkimin nga detyra, lidhet me një vendim gjyqësor të formës së prerë, i cili e ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale të refuzimit për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram të rremë të pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i parë i Kodit Penal.

32. Në nenin 115 të Kushtetutës parashikohet se organi i zgjedhur drejtpërdrejt, i njësishë qeverisëse vendore, mund të shpërndahet ose shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve⁴. Ndërsa, sipas nenit 42/b të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", kryetari i komunës ose bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave kur dënohet për kryerjen e një veprë penale, me vendim të formës së prerë të gjykatës.

33. Kuptimi i veprës penale jepet në nenin 1 të Kodit Penal, në paragrafin e dytë të të cilit thuhet se veprat penale ndahen në krime dhe kundërvajtje penale. Në vlerësimin e Gjykatës, kryerja e një veprë penale përbën formën më të rëndë të shkeljeve të ligjit dhe, në këtë kuptim, formulimi, në dukje, i një shkakut "të ri" për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës ose bashkisë, në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", nuk del jashtë kuptimit dhe përmbajtjes së nenit 115 të Kushtetutës.

34. Detyra e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse shkakut, që ka shërbyer për shkarkimin nga detyra të organit të zgjedhur të qeverisjes vendore, përbën ose jo shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve, dhe jo oportunitetin e masës së marrë. Të drejtën për të vlerësuar marrjen ose jo të masës së shkarkimit nga detyra, kur janë të pranishme kushtet e përcaktuara në nenin 115 të Kushtetutës, kushtetutëbërësi e ka lënë në çmimin e Këshillit të Ministrave kur shprehet se ky i fundit mund të

⁴ Neni 115, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.



shpërndajë ose të shkarkojë organin e zgjedhur drejtpërdrejt të qeverisjes vendore, për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve.

35. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se kryerja e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe që u bë shkak për shkarkimin e tij nga detyra, dëmton rëndë imazhin e organeve të zgjedhura apo nëpunësve publikë, sepse është e lidhur me përmbushjen e rregullt të detyrës.

36. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka pranuar se edhe vetëm deklarimi i rremë i pasurive dhe interesave financiarë, ose mosdeklarimi i tyre, i pashoqëruar me një vendim dënimi penal të formës së prerë (si në rastin në shqyrtim), konsiderohet shkelje e rëndë e ligjit, sepse lidhet me mosrespektimin e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe nga ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (*shih vendimin nr. 15, datë 3.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjykata, gjithashtu, e konsideron si të pabazuar pretendimin e kërkuesit se ai duhet të përfitonte dhe nga ligji nr. 107, datë 28.11.2012 “Për dhënie amnistie”. Në çështjen konkrete ndodhemi para rastit kur ligji nr. 107, datë 28.11.2012 “Për dhënie amnistie” nuk gjen zbatim, pasi vendimi ka marrë formë të prerë dhe është ekzekutuar.

38. Sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa për shfuqizimin e vendimit nr. 159, datë 27.2.2013, të Këshillit të Ministrave, për shkarkimin nga detyra të z.Aleksandër Çela, kryetar i komunës Dardhas, Pogradec, është e pabazuar dhe, si e tillë, duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 115, pika 2 të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj.

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Fatos Lulo.

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk biem dakord me qëndrimin e mbajtur dhe argumentet e parashtruara nga shumica në këtë çështje, e çmojmë të rëndësishme të dalim me mendim pakice.

Shumica, për pretendimin e shkarkimit pa të drejtë nga detyra të kërkuesit, ka konkluduar se ky pretendim është i pabazuar. Përmes arsyetimit të saj, ajo është shprehur se shkelja që i atribuohet kërkuesit lidhet me një vendim gjyqësor të formës së prerë, që e ka deklaruar atë fajtor për veprën penale të refuzimit për deklarim të pasurisë të personave të zgjedhur, të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i parë i Kodit Penal (*paragrafi 31 i vendimit*). Në vlerësimin e shumicës, kryerja e një vepre penale përbën formën më të rëndë të shkeljes së ligjit dhe, në këtë kuptim, parashikimi si shkak për shkarkimin e kryetarit të komunës, i dënimit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, sipas nenit 42/b të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (ligji 8652/2000), nuk del jashtë kuptimit të nenit 115 të Kushtetutës (*paragrafi 33 i vendimit*).

Nuk pajtohem me këto përfundime, ndaj në vijim do të parashtrajmë argumentet për qëndrimin tonë të ndryshëm nga ai i shumicës.

Sipas nenit 115/1 të Kushtetutës, organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për “shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve”. Ndërsa neni 42 i ligjit 8652/2000, përveç shkeljeve të rënda të Kushtetutës ose ligjeve, përcakton si shkak për shkarkimin e kryetarit të komunës, ndër të tjera, rastin kur ky i fundit dënohet për kryerjen e një vepre penale, me vendim të formës së prerë nga gjykata (neni 42/b).

Shumica, nëpërmjet linjës së saj arsyetuese, ka prezumuar që kryerja e një vepre penale, pavarësisht nëse bëhet fjalë për krim apo kundërvajtje penale, përbën shkelje të rëndë të ligjit në kuptimin kushtetues. Për të arritur në këtë konkluzion ajo është mjaftuar me verifikimin e ekzistencës së një dënimi me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Sipas vlerësimit tonë, në ndryshim nga shumica, kryerja e çdo lloj vepre penale, për të cilën është dhënë një vendim i formës së prerë, nuk përbën në çdo rast “shkelje të rëndë të ligjit”, në kuptimin e nenit 115 të Kushtetutës. Këtë qëndrim e mbështesim në argumentet dhe qasjen interpretuese që vijojnë më poshtë.

Gjykata, në veprimtarinë e saj interpretuese, nuk është e kufizuar nga parashikimet ligjore, përkundrazi ajo e ushtron këtë veprimtari brenda juridiksionit të përcaktuar në nenin 124 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet se “Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës”. Nëpërmjet interpretimit që i bën normave ose termave konkretë të Kushtetutës, Gjykata ka për qëllim të përcaktojë standardet kushtetuese mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtaria e organeve kushtetuese dhe kërkesat në ushtrimin e veprimtarisë së tyre vendimmarrëse (*shih vendimet nr. 29, datë 30.6.2011; nr. 29, datë 21.10.2009; nr. 2, datë 19.1.2005; nr. 75, datë 19.4.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

Kushtetuta, për mandatin e deputetit, nuk parashikon procedurë të veçantë për shkarkimin, por përcakton kushtet, vërtetimi i të cilave passjell mbarimin e mandatit. Sipas nenit 71/2/dh, një nga këto kushte është rasti “kur [deputeti] dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi”. Pra, deputetit nuk i mbaron mandati nëse dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një kundërvajtjeje penale. Nga procesverbalet e hartimit të Kushtetutës, vërejmë se hartuesit kanë pasur si qëllim për t’u njohur organeve vendore garanci të përafërta/ngjashme me deputetët (*shih Debati Kushtetues, OSBE, vëllimi i parë i diskutimeve, f. 546-553*). Si deputetët dhe organet e qeverisjes vendore janë funksionare politike që zgjidhen nëpërmjet votës dhe përfaqësojnë zgjedhësit.

Në këndvështrim të nenit 13 të Kushtetutës, garancitë e shkarkimit dhe statusi i funksionarit vendor duhen parë jo si garanci personale ndaj tyre, por si garanci funksionale të autonomisë vendore. Pavarësisht se ushtrimi i kompetencës së shkarkimit nga autoritetet politike shtetërore karakterizohet nga një hapësirë vlerësimi diskrecionale, kjo nuk nënkupton shmangie të garancive që gëzon organi i zgjedhur vendor, në kuptim të neneve 115 dhe 42 të Kushtetutës. Në thelb, kontrolli në këto raste, si procedurë administrative shkarkimi, duhet të baraspeshojë vlerat e pavarësisë dhe të përfaqësimit të organeve të zgjedhura vendore me përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e tyre (*shih mendimin e pakicës në vendimin nr. 32, datë 10.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

Bazuar në standardet e mësipërme, ne vlerësojmë se jo çdo vepër penale duhet të konsiderohet në çdo rast si “shkelje e rëndë ligjit”, në kuptimin kushtetues, por një vlerësim i tillë duhet bërë rast pas rasti. Në ndryshim nga krimet, kundërvajtjet penale karakterizohen nga një rrezikshmëri e ulët për shoqërinë, nisur nga pasojat që ato shkaktojnë dhe shkalla e dënimit që jepet për kryerjen e tyre⁵. Parashikimi i nenit 42/b të ligjit 8652/2000, nuk e detyron Gjykatën t’i përmbahet formulimit të kësaj dispozite ligjore për të interpretuar “shkeljen e rëndë të ligjit”, në kuptimin kushtetues, pasi ajo bën një interpretim autonom të termave dhe koncepteve të përdorura në tekstin e Kushtetutës. Në rastet kur shkarkohet organi i qeverisjes vendore, Gjykata ka një rol vlerësues të pavarur kundrejt shkeljes dhe procedurës së shkarkimit, në kuadër të nenit 115 të Kushtetutës. Një gjykim, i cili ka për objekt shkarkimin nga detyra të organeve të qeverisjes vendore, është gjykim në themel i kërkesës. Gjykata Kushtetuese, si organ kontrolli, për të çmuar shkeljen e rëndë të Kushtetutës apo të ligjit, heton dhe

⁵ Shih Komentarin e Kodit Penal, Pjesa e Përgjithshme, *Elezi, Kaçupi, Haxhia* (2009).



gjykon në themel çështjen, ashtu siç do vepronte një gjykatë e sistemit gjyqësor të zakonshëm (*shih vendimet nr. 15, datë 8.6.2009 dhe nr. 22, datë 7.10.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vendosur disa kriteret për të përcaktuar se çfarë përbën “shkelje të rëndë të ligjit” në kuptimin kushtetues. Ajo ka mbajtur qëndrimin se kuptimi i saktë dhe i drejtë i konceptit “shkelje të rëndë të ligjit”, të parashikuar në nenin 115 të Kushtetutës, vlerësohet në tërësinë e saj nga disa faktorë që lidhen me rëndësinë e ligjit të shkelur, kohëvazhdimin e pasojave, si dhe qëndrimin subjektiv të autorit ndaj shkeljes së kryer (*shih vendimet nr. 15, datë 3.5.2011; nr. 22, datë 7.10.2008; nr. 25, datë 4.5.2000; nr. 50, datë 31.7.2000 të Gjykatës Kushtetuese*). Përveç këtyre kriterëve të përcaktuara nga Gjykata, në këto raste, çmujmë se është e rëndësishme të evidentohet dhe fakti nëse shkeljet e rënda të ligjit janë kryer apo jo gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj.

Kërkuesi, në çështjen në shqyrtim, ka kryer një kundërvajtje penale, të parashikuar në nenin 257/a të KP-së që sanksionon: “*Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj*”.

Ligji që ka shkelur kërkuesi është ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Ky është padyshim një ligj i rëndësishëm, i cili garanton transparencën e gjendjes financiare të organeve të zgjedhura dhe nëpunësve publikë, në funksion të besueshmërisë që ata duhet të përcjellin te publiku. Megjithatë, nisur nga llojet dhe shkalla e dënimeve që jepen për shkelje të këtij ligji (neni 257/a i KP-së), nuk mund të thuhet se ky ligj është nga ligjet më të rëndësishme që janë të lidhura ngushtë me ushtrimin e rregullt të funksionit publik. Për krahasim, vlen të përmendet se korrupsioni aktiv apo shpërdorimi i detyrës janë shkelje shumë më të rënda në raport me refuzimin për të deklaruar pasurinë dhe detyrimet financiare për shkak se dëmet që i sjellin shoqërisë dhe shtetit janë shumë më të mëdha, shpesh edhe me implikime financiare, se sa ato që sjell mosdeklarimi i pasurisë, si në rastin konkret. Që shkelja e ligjit të konsiderohet e rëndë, në kuptim të nenit 115 të Kushtetutës, duhet që aktet dhe sjellja e kundërligjshme e organit të qeverisjes vendore të jenë të tilla dhe të kenë sjellë pasoja/dëme aq serioze për shtetin, sa të detyrojnë organin kompetent (Këshillin e Ministrave) për të marrë masën e shkarkimit nga detyra. Për sa i përket sjelljes së kërkuesit, pra qëndrimin subjektiv të tij ndaj shkeljes së kryer, nga aktet e administruara rezulton se: pasi kërkuesi ka kryer shkeljen e ligjit dhe nuk ka dorëzuar deklaratën brenda afatit të caktuar, ILDKP-ja, me vendimin nr. 81, datë 19.9.2011, i ka vendosur kërkuesit gjobë, në masën 25.000 lekë, për mosdeklarim në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme të interesave private; ky vendim i është komunikuar kërkuesit në datën 22.9.2011; pas kallëzimit penal të paraqitur në prokurori nga ILDKP-ja, në datën 16.1.2012 kërkuesi ka dorëzuar pranë ILDKP-së deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dhe në datën 17.1.2011 ka paguar gjobën prej 25.000 lekësh. Nga dosja gjyqësore nuk rezulton që kërkuesi të jetë shprehur se refuzon deklarimin, por e justifikon vonesën me faktin se nuk ka arritur të regjistrojë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), Pogradec, një apartament në pronësi të tij (*shih faqen 5 të vendimit nr. 43-2012-420, datë 19.3.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec*). Këto rrethana faktike tregojnë se pavarësisht mosdeklarimit të interesave private nga ana e kërkuesit, sipas afateve ligjore, ky i fundit e ka përmbushur, edhe pse me vonesë, detyrimin ligjor të deklarimit duke riparuar në këtë mënyrë shkeljen.

Për më tepër, në datën 28.11.2012, kërkuesi ka përfitur nga ligji për amnistinë nr. 107/2012. Në vlerësimin tonë, fakti që Kuvendi mund të japë amnisti për një vepër penale të një rrezikshmërie të ulët për shoqërinë apo për një kundërvajtje penale, si në rastin në shqyrtim, duhet të ishte marrë në konsideratë dhe vlerësuar nga ana e Këshillit të Ministrave. Megjithatë, çmujmë se është e rëndësishme që një vlerësim i tillë të bëhet rast pas rasti dhe jo *a priori*.

Gjykata ka theksuar në praktikën e saj se, si rregull, përgjegjësia penale konkurron me përgjegjësinë administrative ose disiplinore. Prandaj, pavarësisht nga procedimi penal, Këshilli i Ministrave, si organ administrativ, mund të nisë njëherazi një procedurë administrative për shkelje për të cilat konstatohet përgjegjësia administrative (*shih vendimin nr. 22, datë 7.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Procedura e shkarkimit të kërkuesit, në rastin konkret, është në vetvete një procedim

disiplinor administrativ i iniciuar nga Këshilli i Ministrave, si organi kompetent administrativ. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 159, datë 27.2.2013, e ka shkarkuar kërkuesin me motivacionin “*për shkak të kryerjes së veprës penale*”. Sipas fakteve, regjistrimi i procedimit penal në gjykatë është bërë në datën 13.2.2012 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin nr. 43-2012-420, të datës 19.3.2012, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprën penale të “*refuzimit për deklarinimin...e pasurive të personave të zgjedhur*”, vendim i cili ka marrë formë të prerë në datën 30.3.2012. Nga këto të dhëna rezulton se Këshilli i Ministrave e ka shkarkuar kërkuesin rreth një vit pasi vendimi penal ndaj tij ka marrë formë të prerë (30.3.2012) dhe pas një viti e tetë muaj nga momenti i kryerjes së shkeljes (29.7.2011).

Edhe pse në rastin konkret kemi të bëjmë me një procedim administrativ jotipik, kjo nuk do të thotë që Këshilli i Ministrave, në mungesë të parashikimeve ligjore të posaçme për afatet e fillimit të këtij lloj procedimi disiplinor, të mos marrë parasysh parashikimet ligjore të përgjithshme në këtë drejtim. Kështu, ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, ka parashikuar, në rastet kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, se: organi që konstaton shkeljen duhet pa vonesë ta përcjellë rastin tek organi vendimmarrës (neni 7/2) dhe kur ligjet e posaçme nuk parashikojnë afate të posaçme, shqyrtimi i kundërvajtjes nuk mund të bëhet më vonë se 6 muaj pas kryerjes së saj, por brenda 30 ditëve nga konstatimi (neni 17).

Në përcaktimin e procedurave të shkarkimit, organet përkatëse duhet të respektojnë rregullat për aq sa parashikohet në Kushtetutë, në ligjet organike të tyre, si dhe në aktet e tjera ligjore (*shih vendimin nr. 75, datë 19.4.2002 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo është e rëndësishme sidomos në rastet e shkarkimit të organeve të zgjedhura të qeverisjes vendore për të evituar çdo lloj arbitrariteti me kompetencën e shkarkimit, nga ana e Këshillit të Ministrave. Abuzimi mund të jetë edhe me karakter politik, për shkak të përkatësisë politike të organeve të qeverisjes vendore, duke përfituar nga fenomene të pranishme te këto organe si: mungesa e informacionit, arsimimi jo i përshtatshëm, kapacitete të pakta administrative, njohja jo e mjaftueshme e ligjit etj. Pikërisht, ky lloj arbitrariteti duhet shmangur, ndaj dhe roli vlerësues i Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me shkeljen dhe procedurën e shkarkimit, është tejet i rëndësishëm.

Nisur nga argumentet dhe arsyetimi i mësipërm, çmojmë se shumica nuk ka vlerësuar në rastin konkret nëse shkelja që i atribuohet kërkuesit përbën “shkelje të rëndë të ligjit”, në kuptim të nenit 115 të Kushtetutës, por është mjaftuar vetëm me konstatimin formal të faktit se kërkuesi është deklaruar fajtor nga gjykata për kryerjen e një vepre penale. Shkelja e kryer nga kërkuesi, kohëzgjatja, sjellja e tij dhe pasoja e ardhur nuk përmbushin kushtet për të justifikuar marrjen e vendimit, nga Këshilli i Ministrave, për shkarkimin e tij nga detyra. Për pasojë, shumica duhej të pranonte kërkesën dhe të shfuqizonte vendimin nr. 159, datë 27.2.2013 të Këshillit të Ministrave.

Anëtarë: Fatos Lulo, Sokol Berberi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 30.7.2013
Doli nga shtypi më 30.7.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 32 lekë